

KËRKESË

Nr. 3781, datë 4.7.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruktion i rrugës “Mujo Ulqinaku” dhe “Rehabilitimi i fasadave”, Fier.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 2 403 668 (dy milionë e katërqind e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi**

VLERESIME PARAPRAKE PER PASURITE PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE REALIZIMIT TE PROJEKTEVE PER INTERES PUBLIK

Lista emerore e pronareve, pasurite e te cileve do te shpronesohen per realizimin e projektit " Rikonstruksion i rruges Mujo Ulqinaku dhe hapësirave perreth saj dhe rehabilitimi i fasadave" Fier

Nr.	Emer Mbiemer	Zona Kadastrale	Nr. Pasurise	Sip. Pergj. Truallit (m²)	Sip. Prekur Truallit (m²)	Cmimi per truallin (leke / m³)	Vlera e truallit (leke)	Sip. Totale Nderteses me certificate (m²)	Sip. Prekur Nderteses (m²)	Amortizimi (%)	Vlera e Nderteses me preventiv (leke)	Vlera e Pergjith. (leke)	Gjendja juridike e pasurise
1	Mynevere Alush Gilani & 5 b/pronare	8533	3/883	1,855.0	218.0	11,026	2,403,668	-	-	-	-	2,403,668	Konfirmimi nga Z.V.P.P
Vlera Totale												2,403,668	

Vleresimi eshte bere duke zbatuar VKM nr.138 date 23.03.2000 "Per kriteret teknike te vleresimit dhe te perilogaritjes se mases se shperblimit te pasurive prone private qe zhvleresohen dhe te te drejtave te personave te trete per interes publik" dhe VKM nr. 89 date 03.02.2016 "Per miratimin e hartes se vleres se tokes ne Republiken e Shqiperise"